



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1292/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Nora Ballazhit – Kandidate për Anëtare të Kuvendit Komunal nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Hani i Elezit, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, në Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 13.12.2013, morri këtë:

VENDIM

Hidhet si e pa afatshme ankesa e Nora Ballazhit – Kandidate për Anëtare të Kuvendit Komunal nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dega në Hani i Elezit.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 11.12.2013 nga parashtruesja e ankesës Nora Ballazhi (LDK) ku pretendohet se, në procesverbalin e dt. 03.11.2013, në VV 33020/010 nga ana e komisionarëve në procesverbal janë proceduar 17 vota në kuti, në të njëjtin VV, ndërsa me datë 02.12.2013 në tabelën e publikuar të KQZ-së nga po i njëjti VV nuk më figuron asnjë votë, pra këtu flitetet për gabime teknike dhe manipulime të bëra nga KQZ-ja, duke theksuar se ankesa është e bazuar dhe e mbështetur në argumente.

Në cilësinë e provës parashtruesja e ankesës e ka bashkangjitur si dëshmi formularin e rezultateve të kandidatëve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmerinë e ankesës gjeti se:

ankesa është e pa afatshme

Me ankesën e parashtruar nga Nora Ballazhi – Kandidate për Anëtare të Kuvendit Komunal (LDK), pretendohet se në VV nr. 33020/010 janë bërë manipulime dhe gabime teknike me rastin e numërimit të votave nga KQZ-ja, gjë që nuk më figuron asnjë votë.

PZAP-i, konstatoi nga shkesat e lëndës se ankesa e Nora Ballazhit – Kandidate për Anëtare të Kuvendit Komunal (LDK) është e pa afatshme sepse afati ligjor sipas LKP-së është 24 orë nga momenti i shpalljes së vendimit nga KQZ-ja e që nënkupton se ky afat ka qenë deri më datë 03.12.2013 ora 16:30, ndërsa pala ankuese ankesën në

fjalë e ka parashtruar në PZAP me datë 11.12.2013 ne ora 14:10. Prandaj duke u bazuar në nenin 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it dhe nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 1292/2013 më datën 13.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.